# CFRR REPARIS

FORCIMI I QEVERISJES SË KORPORATAVE NË SHQIPËRI DHE KOSOVË: RAPORTIMI I QËNDRUESHMËRISË DHE RRITJA E ROLIT TË KOMITETEVE TË AUDITIMIT

# Kërkesat dhe Standardet e Reja Evropiane të Raportimit të Qëndrueshmërisë

10 Nëntor 2022

EFRAG

# DEKLARIM I MOSMBAJTJES SË PËRGJEGJËSISË

Pikëpamjet e shprehura në këtë prezantim janë ato të prezantuesve, përveç rasteve kur tregohet ndryshe. Ato nuk janë të miratuara nga: Bordi Administrativ i EFRAG, Bordi i Raportimit Financiar (FRB) të EFRAG, Grupi i Ekspertëve Teknikë të Raportimi Financiar (FR TEG) të EFRAG, Bordi i Raportimit të Qëndrueshmërisë (SRB) të EFRAG dhe Grupi i Ekspertëve Teknikë të Raportimit të Qëndrueshmërisë (SR TEG) të EFRAG.

# RRETH EFRAG

## HISTORIK dhe HYRJE

### KUSH ËSHTË EFRAG



EFRAG

Një organizatë private jofitimprurëse e krijuar në vitin 2001

E inkurajuar nga KE për t'i shërbyer interesit publik

Prej vitit 2010 më shumë se 50% e financimit vjen nga Bashkimi Evropian

2018: krijimi i Laboratorit Evropian të Raportimit të Korporatave nw EFRAG (European Corporate Reporting Lab@EFRAG) në zbatim të Planit të Veprimit të KE-së: *Financimi i rritjes së Qëndrueshme*

2022: organizimi i Shtyllës së raportimit të qëndrueshmërisë

EFRAG

# NJË VËSHTRIM MBI AKTIVITETET E EFRAG

## Deklarata e Misionit të EFRAG

- Misioni i EFRAG është që t'i shërbejë interesit publik evropian si për raportimin financiar ashtu edhe për raportimin e qëndrueshmërisë nëpërmjet zhvillimit dhe promovimit të pikëpamjeve evropiane në fushën e raportimit të korporatave dhe përgatitjes së drafteve të Standardeve të BE-së për Raportimin e Qëndrueshmërisë.
- **Në lidhje me Raportimin Financiar, EFRAG:**
  - Siguron që pikëpamjet evropiane merren në konsideratë në mënyrën e duhur në procesin e përcaktimit të standardeve të BSNK-së dhe në debatet ndërkombëtare përkatëse
  - Ofron këshilla për KE-në nëse Standardet e reja ose të rishikuara SNRF përmbushin kriteret e Rregullores së SNK-së për t'u miratuar për përdorim në BE, përfshirë nëse miratimi i tyre i shërben të mirës publike evropiane
- **Në lidhje me Raportimin e Qëndrueshmërisë, EFRAG:**
  - Ofron këshilla teknike për KE-në nëpërmjet përgatitjes së drafteve të Standardeve të Raportimit të Qëndrueshmërisë së BE-së të shoqëruar me parimet bazë të përfundimeve dhe analiza të kostove dhe përfitimeve, përfshirë analizën e ndikimit.

# NJË VËSHTRIM MBI AKTIVITETET E EFRAG

## Deklarata e Misionit të EFRAG (vazhdim)

- EFRAG, gjatë gjithë procesit të përcaktimit të standardeve. kërkon opinion nga të gjitha palët e interesuara dhe merr prova në lidhje me rrethanat specifike evropiane.
- Legjitimiteti i EFRAG është i ndërtuar mbi transparencën, qeverisjen, procesin e duhur (që mund të përfshijë testime në terren, analizë të ndikimit dhe shtrirjes), përgjegjshmërinë publike dhe lidershipin e mendimit.
- EFRAG të flasë në mënyrë bindëse, të qartë dhe të qëndrueshme dhe të njihet si zëri evropian në raportimin e korporatave.
- EFRAG është duke punuar në një mjedis me zhvillim të shpejtë. Ajo është e vëmendshme ndaj nevojës për të përshtatur aktivitetet e saj për të përmbushur mundësitë dhe sfidat e reja në fushën e raportimit të korporatave.

# KE DHE CSRD



## FINANCAT E QËNDRUESHME

### INICIATIVAT E KE-së

- Raporti i vitit 2018 i Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë *Financimi i një Ekonomie të Qëndrueshme Evropiane*
- Plani i Veprimit i KE-së i Mars 2018 për *Financimin e Rritjes së Qëndrueshme*, veçanërisht seksioni Deklarimi dhe Kontabiliteti: Pikat e Veprimit
  - EFRAG të krijojë një Laborator Evropian të Raportimit të Korporatave (i krijuar në TM3 2018)
  - Qershor 2019: Shtojca e NFRD-së mbi raportimin e informacionit të lidhur me klimën
  - Gjysma e para e vitit 2020: Konsultimi i BE-së mbi strategjinë e rinovuar të financave të qëndrueshme
  - Tetor 2018: Kontrolli i Përshtatshmërisë (Fitness Check) i vitit 2018 i KE-së– raport përmbledhës
- Marrëveshja e Gjelbër Evropiane e Dhjetor 2019 që përfshin nevojën për shtim të deklarimit të të dhënave të lidhura me klimën dhe mjedisin => rishikim i NFRD-së

European Reportin
@EFRAG

# NJË PAMJE E SHPEJTË E CSRD-së

- **Fushëveprimi** u zgjerua për të përfshirë të gjitha kompanitë e mëdha dhe të gjitha kompanitë e listuara, plus disa kompani jo-evropiane (të BE-së).
- E detyrueshme, standarde evropiane…
- Draftet janë përgatitur nga EFRAG në rolin e këshilluesit teknik
- Miratuar nga KE si akte të deleguara.
- Standardet sipas tematikës dhe sektorit.
- Standarde proporcionale për NVM-të e listuara dhe standarde për kompani jo-BE.
- Kërkesa për garantimin e raportimit, duke filluar me kërkesa të kufizuara, më vonë të arsyeshme

# NJË REGJIM I FORTË I DETYRUESHËM I RAPORTIMIT TË QËNDRUESHMËRISË NË BE

- Një regjim ligjor i raportimit të qëndrueshmërisë me materialitet/rëndësi të dyfishtë

  Direktiva e Raportimit të Qëndrueshmërisë së Korporatave — Niveli 1

  ↓

  Standardet Evropiane të Raportimit të Qëndrueshmërisë — Niveli 2

  ⇨ *Të përpunuara nga EFRAG* ⇨ *Këshilla Teknike për KE-në*

  ⇨ *Të miratuara nga KE si akte të deleguara*

- Mbulim gjithëpërfshirës i çështjeve mjedisore, sociale dhe të qeverisjes: fillimisht për sektorët në përgjithësi, më pas sipas sektorëve specifikë

- Raportimi vendoset në një seksion të veçantë të raportit të menaxhimit me titull: Deklaratat e qëndrueshmërisë

## FUSHËVEPRIMI

- ✓ Të gjitha kompanitë > 250 punonjës që operojnë me Bashkimin Evropian
  - ✓ Të gjitha kompanitë e mëdha
  - ✓ Të gjitha kompanitë e listuara (përveç mikro-ndërmarrjeve të listuara)
- ✓ NVM-të e listuara
- ✓ Regjim i deklarimit vullnetar për NVM-të e tjera
- ✓ *Kompanitë jo-Evropiane (të BE-së) me degë ose filiale në BE mbi kufijtë e caktuar*

**NVM-të e listuara**:

- Alternativë për të përdorur standarde më të thjeshta, proporcionale
- *Mundësia për përjashtim për 2 vjet pas fillimit të zbatimit*

***Jo-BE:***

- *Standarde të veçanta*
- *Nuk mbulon të gjitha fushat e raportimit: fokusi mbi ndikimit, pa raportim mbi rreziqet*

## FILLIMI I ZBATIMIT ME FAZA

- “Kompanitë NFRD”: VF 2024 (raportet e para të publikuara në vitin 2025)
- Kompani të tjera të mëdha: VF 2025 (raportet në vitin 2026)
- NVM-të e listuara: VF 2026 (raportet në vitin 2027)
- Kompanitë jo-BE me degë/filiale në BE: VF 2028 (raportet në vitin 2029)

Zinxhiri i vlerës: Standardet nuk mund të "specifikojnë deklarime informacioni që do t'u kërkonin ndërmarrjeve të marrin informacion nga NVM-të që janë pjesë e zinxhirit të tyre të vlerës që tejkalon informacionin që duhet të deklarohet sipas" standardeve për NVM-të e listuara.

# KE MERR NË KONSIDERATË KËSHILLËN E EFRAG, NËSE AJO

- Është përgatitur sipas një procesi të duhur, me mbikëqyrje publike dhe transparencë ndaj palëve të interesuara
- Është përgatitur me financim nga fonde publike në masë të mjaftueshme për të siguruar pavarësinë e saj
- Është hartuar në bazë të një programi pune mbi të cilin është konsultuar KE-ja (KE duhet të konsultohet me PE-në dhe Shtetet Anëtare)
- Është e shoqëruar me analiza kosto-përfitim
- Është e shoqëruar nga një shpjegim se ajo merr parasysh iniciativat dhe legjislacionin e cituar në Nenin 29b(3)
- Pjesëmarrja në punën teknike të EFRAG bazohet në ekspertizën në raportimin e qëndrueshmërisë dhe nuk kushtëzohet nga ndonjë kontribut financiar

# AFATET KOHORE TË KE-së PËR MIRATIMIN E STANDARDEVEE

## 30 Qershor 2023

- standardet për të specifikuar informacionin për raportim sipas neneve 19a/29a (të gjitha tematikat e qëndrueshmërisë)
- duke mbuluar të paktën nevojat e pjesëmarrësve të tregut financiar sipas SFDR

## 30 Qershor 2024

- Standardet specifike sektoriale
- Standardet për NVM-të e listuara
- Informacion plotësues aty ku është e nevojshme
- Standardet për kompanitë jo-BE

**Shënim**

- rishikim i detyrueshëm dhe ndryshim i mundshëm i çdo standardi në çdo 3 vjet
- një periudhë minimalisht 4 mujore ndërmjet miratimit nga KE-jë dhe afatit të fillimit të zbatimit

# ZHVILLIMET E EFRAG

# Udhëtimi i qëndrueshmërisë së EFRAG: Laboratori Evropian

## DOKUMENTA TË PËRGATITUR







Stimulimi i inovacionit në fushën e raportimit të korporatave në Evropë nëpërmjet identifikimit dhe shpërdarjes së praktikave të mira – tre projekte që përfshijnë raportimin e informacionit të lidhur me klimën; raportimin mbi rreziqet dhe mundësitë dhe lidhjen me modelin e biznesit






# GURË KILOMETRIKË

Publikimi i raporteve finale me rekomandime – 8 mars 2021

Publikimi i propozimit për një CRSD – 21 prill 2021

Letër për Komisioneren McGuinnesss, ftesë për të filluar hartimin e standardeve nëpërmjet një projekti duke marrë parasysh zhvillimet ndërkombëtare dhe për të filluar reformën e qeverisjes - 12 maj 2021

Konsultim publik mbi Procedurat e Procesit të Duhur për Përcaktimin e Standardeve të Raportimit të Qëndrueshmërisë së BE-së (DPP) – Raporti përmbledhës i publikuar në nëntor 2021 – Miratimi nga Asambleja e Përgjithshme e DPP EFRAG - 15 mars 2022

Pranimi i 14 Organizatave të reja në shtyllën e raportimit të Qëndrueshmërisë të EFRAG (përfshirë 11 Organizata të Shoqërisë Civile), që i shtohen 17 organizatave ekzistuese - Dhjetor/Janar/Shkurt 2022

Miqtë e EFRAG – Raportimi i Qëndrueshmërisë

Miratimi i Statutit dhe Rregullave të Brendshme të EFRAG - Janar 2022

Ftesë nga KE për aplikim të kandidatëve për Kryetar të SRB të EFRAG dhe për Kryetar të FRB të EFRAG – afati 1 shkurt 2022: emërimet nga KE pritet të kryhen së shpejti









# REFORMA INSTITUCIONALE E EFRAG PËR T'IU PËRSHTATUR MISIONIT TË RI



# GURË KILOMETRIKË (VAZHDIM)

EFRAG

Ftesë për aplikim për kandidatët për Bordin e Raportimit të Qëndrueshmërisë të EFRAG – afati 10 shkurt 2022, emëruar nga Asambleja e Përgjithshme e EFRAG më 1 mars 2022

Ftesë për aplikim për kandidatët për Grupin e Ekspertëve Teknik (TEG) të Raportimit të Qëndrueshmërisë të EFRAG – afati 28 shkurt 2022 - emëruar nga SRB e EFRAG më 13 Prill 2022 + 2

Task Forca e Projektit të Tranzicionit mbi Standardet Evropiane të Raportimit të Qëndrueshmërisë (PTF-ESRS) në structure të përhershme – maj/qershor 2022

Konsultim publik mbi draft-propozimet e grupit të parë të draftit të standardeve ESRS-Prill 2022 me afat deri më 8 gusht 2022 Argumentat për përfundimet e publikuara më 31 maj (jo për komente)

Sesione të përbashkëta për Edukimin Publik midis SRB të EFRAG dhe SRT të EFRAG – sesionet e regjistruara janë të disponueshme

Evente dhe aktivitete të angazhimit me publikun me fokus vendet dhe palët e interesuara gjatë konsultimit publik maj-korrik 2022

Analiza e kostos së përfitimit përfshirë vlerësimet e ndikimit – TM3 2022

Analiza e letrës së komenteve, diskutimet, grupi i parë i draftit të ESRS

Ftesë për ofertë mbi përgatitjen e Taksonomië së XBRL të grupit të parë të draftit të ESRS: afati përfundimtar 24 tetor 2022

# DRAFTI I ESRS

# PËRPUNIMI DHE MIRATIMI I GRUPIT TË TË PARË TË STANDARDEVE: KOHËZGJATJA 34 MUAJ



## PROGRESI DERI MË SOT

- ✓ 13 Draft-Propozime (ED) deri në Prill 2022 : grupi i parë i draftit të standardeve ESRS publikuar për komente deri më 8 gusht 2022
- ✓ Gjatë periudhës së konsultimit publik (maj-gusht):
  - ✓ Tranzicioni drejt structures së përhershme
  - ✓ 16 angazhime kontakti në nivel vendi dhe të palëve të interesuara
  - ✓ Sesione edukuese për çdo ED
- ✓ Diskutimi i rezultateve të konsultimit publik (>700 përgjigje për konsultimin)
- ✓ Takimet SRB të EFRAG dhe TEG të EFRAG për SR janë **publike**
- ✓ **Programi i punës për vitin 2023** për KE, PE dhe Këshillin

# DRAFT-PROPOZIMET

**Standardet ndërsektoriale**
- ESRS 1 Parime të përgjithshme
- ESRS 2 Strategjia e përgjithshme, qeverisja dhe vlerësimi i materialitetit

**Mjedisi**
- ESRS E1 Ndryshimet klimatike
- ESRS E2 Ndotja
- ESRS E3 Burimet e ujit dhe detit
- ESRS E4 Biodiversiteti dhe ekosistemet
- ESRS E5 Burimet dhe ekonomia qarkulluese

**Sociale**
- ESRS S1 Fuqia e vet punëtore
- ESRS S2 Punëtorët në zinxhirin e vlerës
- ESRS S3 Komunitetet e prekura
- ESRS S4 Konsumatorët dhe përdoruesit fundorë

**Qeverisja**
- ESRS G1 Qeverisja, menaxhimi i riskut dhe kontrolli i brendshëm
- ESRS G2 Sjellja e biznesit



## PROGRESI DERI MË SOT

- ✓ Analiza e kostove dhe përfitimeve
  - ✓ e zhvilluar në bazë të ED-ve, por për t'u përditësuar për draft-standardet ESRS
  - ✓ Në bazë të vlerësimit të ndikimit të NFRD
  - ✓ Të gjithë palët e interesuara
  - ✓ Përveç kostove janë vleërsuar dhe përfitimet
- ✓ Taksonomia e XBRL për grupin e parë të standardeve ESRS
  - ✓ Afati i fundit i dorëzimit të ofertave më 24 tetor 2022
  - ✓ Ndërtimi i kapaciteteve të brendshme
  - ✓ Forumi Konsultativ i Taksonomisë i EFRAG për ESRS
  - ✓ Koordinim me XBRL International dhe Fondacionin IFRS

# TEMA THEMELORE – VENDIMET PARAPRAKE

- Qasja e materialitetit (zëvendëson supozimin e kundërshtueshëm me vlerësimin e materialitetit)
- Udhëzime shtesë për materialitetin e dyfishtë
- Ndryshimet e CSRD
- SFDR, kërkesat standarde të BE-së dhe Shtylla e përgjithshme 3 e detyrueshme (vlerësimi i jashtëm i materialitetit)
- Përafrimi me ISSB – në masën maksimale të mundshme në afatin kohor të disponueshëm, ndryshime në vitet e ardhshme – Përafrimi me GRI
- Thjeshtim i konsiderueshëm (numri i DR-ve/detajimeve/gjuhëve), pas analizës së detajuar të rëndësisë për të thjeshtuar - shiko pemën e vendimit në faqen tjetër të prezantimit
- Fillimi i zbatimit: me faza (përfshirë 3 vjet për zinxhirin e vlerës)
- Diligjenca e duhur: përafrim më i fortë me udhëzimet ndërkombëtare pa paracaktuar përmbajtjen e CSDDD-së së ardhshme

# FOKUSI NGA QERSHOR DERI NË NËNTOR 2022

EFRAG



# NJË ARKITEKTURE KOHERENTE E STANDARDEVE : 12 STANDARDE ESRS

EFRAG

Ndër-sektoriale

**ESRS1**
Kërkesa të Përgjithshme

**ESRS2**
Deklarime të Përgjithshm
e

- Qeverisja
- Strategjia
- Menaxhimi i ndikimit/R
- Tregues të matjes dhe

T E M A T I K E

**Mjedisi**

E1: Ndryshimi i klimës
E2: Ndotja
E3: Burimet ujore dhe detare
E4: Biodiversiteti dhe Ekosistemet
E5: Burimet dhe ekonomia qarkulluese

**Sociale**

S1: Fuqia e vet punëtore
S2: Punëtorët në zinxhirin e vlerës
S3: Komunitetet e prekura
S4: Klientët dhe përdoruesit fundorë

**Qeverisja**

G1: Sjellja e biznesit

# KËSHILLA TEKNIKE E FINALIZUAR PËR 15 NËNTOR 2022



# NDËRVEPRUESHMËRIA/PËRAFRIMI ME ISSB

- Takime të Grupit të Përbashkët të Punës (JWG), takime dypalëshe në nivel menaxherial dhe takime dypalëshe të ekspertëve të klimës: dialog dhe bashkëpunim i vazhdueshëm
- Komentet e marra: dëshirë e madhe për ndërveprim të ESRS dhe SNRF S
- Vendimet e paraprake:
  - Përafrimi i koncepteve: materialiteti financiar dhe zinxhiri i vlerës në ESRS 1
  - Përafrimi i përmbajtjes së objektivave të deklarimit në ESRS 2
  - Konfirmimi i shtesave të SNRF S2 në ESRS E1
  - Ndryshime në Arkitekturë
- Ndryshime në afatet kohore



# PËRMBAJTJA E GRUPIT 2 TË DRAFTIT TË STANDARDEVE ESRS

- Standardet specifike sektoriale
  - 5 sektorë që mbulohen nga GRI: Bujqësia, Minierat e Qymyrit, Minierat, Naftë+Gaz (në rrjedhën e sipërme), Naftë+Gaz (në rrjedhën e mesme deri në të poshtmen)
  - 5 sektorë me ndikim të lartë: Prodhimi i Energjisë, Transporti Rrugor, Prodhimi i Automjeteve, Ushqimi/Pijet, Tekstilet
- Standard për kompanitë jo-BE
- Standard për NVM-të e listuara
- Udhëzime për deklarim vullnetar për NVM-të e palistuara
- Amendamenti në Grupin 1 për të zbatuar ‘vlerën kufi' në informacionin e zinxhirit të vlerës => ***ka shumë mundësi të vendoset 3***

Puna për draftet e standardeve sektoriale të ESRS është në vazhdim (seminare të zhvilluara në qershor/korrik) dhe një grup i ri seminaresh në tetor/nëntor (zëri i lajmve)

Pasuar nga dy grupe të tjera standardesh specifike sektoriale

## AFATET KOHORE PARAPRAKE

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Përgatitja | Konsultimi | Analiza e komenteve/AKP/Rishqyrtimi | Digjitizimi |
| Grupi 1 | | 1 Maj - 8 Gusht 2022 | 9 Gusht 2022 - 15 Nëntor 2022 | Nëntor 2022 - Shtator 2023 |
| Grupi 2 | Gusht 2022 - Shkurt 2023 | Mars/Prill-Qershor 2023 (e shpërndarë në kohë) | Korrik 2023- Nëntor 2023 | Nëntor 2023 - Shtator 2024 |
| Grupi 3 | Gusht 2023 - Shkurt 2024 | Mars - Qershor 2024 | Korrik 2024- Nëntor 2024 | Nëntor 2024 - Shtator 2025 |
| Grupi 4 | Gusht 2023 - Shkurt 2025 | Mars - Qershor 2025 | Korrik 2025- Nëntor 2025 | Nëntor 2025 - Shtator 2026 |

EFRAG bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian dhe vendet e EEA dhe EFTA. Megjithatë, përmbajtja e punës së EFRAG dhe pikëpamjet dhe qëndrimet e shprehura janë përgjegjësi e vetme e EFRAG dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian ose të Drejtorisë së Përgjithshme për Stabilitetin Financiar, Shërbimet Financiare dhe Bashkimim e Tregjeve të Kapitalit (DG FISMA). As Bashkimi Evropian dhe as DG FISMA nuk mund të mbajnë përgjegjësi për to.

EFRAG

EFRAG
Aisbl - ivzw
35 Square de Meeüs
B-1000 Brussel
Tel. +32 (0)2 207 93 00
**www.efrag.org**